NUK KA NGATËRRIM MES AJETEVE...

PIKA TE ARTA PËR UDHËZIMIN E NJERËZISË

INTERVISTË ME HIRËSINË E TIJ, SHEJKH SHUAJB ARNAUTI

Viti XIV - Nr. 10 (164), Tetor, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme Informative - Fetare Kulturore - Edukative

"QËNDRONI, MOS E LENI KTE FÉ! RUNE BESËN E T'PARVE TUJ!"

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, SHEJKH SHUAJB MUHARREM ARNAUTI

Mbrëmjen e së enjtes, më 27 tetor 2016, në kryeqytetin e Jordanisë, Amman, ndërroi jetë në moshën 88 vjeçare dijetari i shquar islam me prejardhje shqiptare, nga qyteti i Shkodrës, Hirësia e Tij, Shejkh Shuajb Arnauti.

Enciklopedisti i shquar islam, Shuajb Arnauti, lindi në vitin 1928 në Damask të Sirisë, një vit pasi i ati, Muharremi, emigroi drejt Damaskut, bashkë me familjen e tij...

"QËNDRONI, MOS E LENI KTE FÉ! RUNE BESËN E T'PARVE TUJ!"

"Vdekja e dijetarit është një fatkeqësi, që nuk ka ngushëllim, një boshllëk, që nuk mbyllet! Vdekja e një fisi është më e lehtë se vdekja e një dijetari. Ai është një yll që u shua!"

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, i Cili krijoi vdekjen dhe jetën, si sprovë për kalimtarët në këtë jetë kalimtare.

Atij i përulemi dhe Njësinë e Tij dëshmojmë, ashtu siç urdhëron edhe në Kur'anin Famëlartë: "All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, edhe melekët edhe njerëzit e dijes...."

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës sonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), të dërguarit mëshirë për mbarë botrat. Më i dituri, më i urti, madhëruesi i dijes dhe gradës së dijetarëve.

Transmetohet, se: "Kur vdes një dijetar, në Islam hapet një boshllëk, që nuk e mbyll asgjë, deri në ditën e kiametit" Sikurse transmetohet, se: "Vdekja e dijetarit është një fatkeqësi, që nuk ka ngushëllim, një boshllëk, që nuk mbyllet! Vdekja e një fisi është më e lehtë se vdekja e një dijetari. Ai është një yll që u shua!"

Transmetohet se, Ibn Abbasi (r.a), teksa komentonte ajetin kur'anor: "A nuk shohin ata se Ne i sjellim pakësimin e tokës (së tyre) nga të gjitha anët e saj", tha: "Vdekja e dijetarëve të saj!" Sikurse është transmetuar, se: "Vdekja e një dijetari është më e dashur për shejtanin se vdekja e shtatëdhjetë adhuruesve!"

TË NDERUAR E TË SHTRENJTË VËLLEZËRIT E MI,

Mbrëmjen që kaloi, mbarë bota islam, nga Lindja në Perëndim, mori lajmin e ndërrimit jetë në kryeqytetin e Jordanisë, Amman, të dijetarit të madh shqiptar, arnautit damasken me prejardhje nga Shkodra, "shërbëtori i hadithit sherifë", "më i madhi i dijetarëve të Synetit, i angazhuar me verifikimin e librave të Traditës", "njëri prej shtyllave të verifikimit të rrënjëve të Traditës Profetike", Shejkh Shuajb Muharrem Arnauti, në moshën 88 vjeçare.

Dr. Jusuf El-Karadavi, ngushëllonte kështu: "E mëshiroftë All-llahu vëllanë tonë, dijetarin, verifikuesin, Shuajb Arnauti, alimin e hadithit, shërbëtorin e Traditës së pastër profetike! All-llahumme fale, pranoje në mesin e të mirëve dhe lartësoja gradët në xhennet!"

TË DASHURIT E MI,

Alimi i madh, Shejkh Shuajb Arnauti, u lind në vitin 1928 në Damask, një vit pasi i ati, Muharrem Arnauti, emigroi nga Shkodra drejt Damaskut.

Arritjet shkencore të këtij shqiptari të madh, e bëjnë atë njërin ndër personalitet e veçanta shkencore islame, që është marrë gjatë tërë jetës së tij me verifikimin shkencor të veprave të rëndësishme islame, si: "Sherhus-Sunneh", të Imam Begaviut, 16 vëllime. "Raudatu-talibine", i Imam Neveviut, 12 vëllime, (në bashkëpunim me dijetarin tjetër shqiptar, Shejkh Abdulkadir Arnauti). "Muhedh-dhebul-egani", të Ibni Mendhurit, 12 vëllime. "El-Mubdiu fi sherhil-Mukanna", të Imam Ibn Muhlih hanbeliut, 10 vëllime. "Zadul-mesir fi ilmit-tefsir", të Ibnul-Xheuziut, 9 vëllime, (në bashkëpunim me dijetarin tjetër shqiptar, Shejkh Abdulkadir Arnauti). "Sijer a'lamun-nubela", të Imam Dhehebiut, 25 vëllime. "Sunen Et-Tirmidhi", 16 vëllime. "Sunen En-Nesai", 12 vëllime. "Sunen Ed-Darekutni", 5 vëllime. Etj.

TË DASHURIT E MI,

Emrin e madh të Hoxhës e kam dëgjuar dhe lexuar për herë të parë në Damask, kur ende isha student. Shejkh Shuajb Arnauti jetonte dhe punonte në Amman të Jordanisë, ku ne e kishim thuajse të pamundur ta vizitonim.

Në vitin 2004, teksa përgatitesha të botoja monografinë mbi jetën e Hoxhës tim, Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, u lidha me telefon me Hoxhën Shuajb Arnauti. Ishte hera e parë që komunikonim. Biseda, jo fort e shkurtër, nisi në shqip dhe u përzi me arabishten e pastër të dijetarit të arabishtes... Atë ditë, isha mbushur me një emocion të madh. Tingulli i zërit të tij kishte një ëmbëlsi të papërshkrueshme. Nuk e harroj, kur më tha: "Esh-Shejkh Vehbi, alimun mutemessikun bil-medhhebil-hanefijji bi-edhafiruh": "Shejkh Vehbiu, është një dijetar i kapur për thonjsh pas medhhebit hanefi"...

Më 7 korrik 2011, pas shumë e shumë kohësh u takuam për herë të parë në Shkodër. Nuk kam fjalë ta përshkruaj atë moment fatlum dhe ditët e pakëta të qëndrimit të tij në Shkodër...

Atë pasdite, teksa merrte në dorëzim titullin: "Qytetar Nderi" i Shkodrës, (për të cilin falënderoj Këshillin e Bashkisë Shkodër, që e mori në konsideratë kërkesën e Myftinisë Shkodër), para një turme të madhe të ftuarish, bëri deklaratën e tij të madhe në gjuhën shqipe: "Me gjak jam shqiptar, por feja jeme asht Islami!".

Ndërkohë, të nesërmen, më 8 korrik 2011, gjatë dersit të xhumasë në xhaminë e Parrucës, dha një këshillë të madhe për të gjithë, kur na u drejtua: "Pavarësisht kohërave të errëta që kaloi vendi, duhet që sot, të zgjoheni

ME VEPRIMIN E TYRE, KËTA TË RINJ BESIMTARË E QYTETARË ELITARË, SIKUR MBAJNË ME DUAR TË PASTRA AMANETIN E SHEJKH SHUAJB ARNAUTIT TË MADH: "PAVARËSISHT KOHËRAVE TË ERRËTA QË KALOI VENDI, DUHET QË SOT, TË ZGJOHENI DHE TË RUANI AMANETIN E TË PARËVE TUAJ! QËNDRONI, MOS E LENI KTE FÉ! RUNE BESËN E T'PARVE TUJ!"

dhe të ruani amanetin e të parëve tuaj! Qëndroni, mos e leni kte fé! Rune besën e t'parve tuj!"

TË DASHURIT E MI,

Sot, për herë të parë, nga 7 korriku 2011, dua të ndaj me ju një "ixhazet" nga dora e Shejkh Shuajb Arnautit, me të cilin më begatoi All-llahu Mëshirëplotë, në tekstin e të cilit shkruhet:

"7/7/2011 M.

BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIM

Pastaj them: Unë i jap ixhazet vëllaut dhe shokut tim, Shejkh Muhamed Sytarit Shqiptarit, Mytiut të Shkodrës, hadithin që e transmeton Ahmedi dhe As'habus-Sunen: "Mëshiruesit i mëshiron Mëshiruesi! Mëshironi ata që janë në tokë, ju mëshiron Ai që është në qiell!".

Prej tij shpresohet t'i mëshirojë njerëzit dhe të zgjedhë për ta, në fetvatë e tij, atë që është më e lehta dhe më e forta drejt së drejtës, me shpresën që kjo duá ta përfshijë edhe atë!

All-llahu jep mbarësi drejt së drejtës!

E shkroi, në qytetin e Shkodrës, vendi, ku ka rënë koka e të atit, Shuajb Muharrem Arnauti (Firma)"

Është pikëlidhja ime me Hoxhën tim, Shejkh Shuajb Arnauti. Amaneti, që la në duart e mia e, që i lutem All-llahut të më bëjë të denjë ta mbaj mbi supe e ta përhap kudo, sa të kem frymë e jetë!

Për fund të këtij ngushëllimi jo të zakontë,

Për disa orë mbrëmë, nuk fola asnjë fjalë. Nuk më flitej, xhanëm. Shfletova gjithandej. Kudo nëpër botë, lajmi i kësaj ndarjeje nga jeta, shoqërohej me ngushëllime e vlerësime të jashtëzakonshme për këtë kolos të dijes, përveçse nga vendi im...

Askush nuk u kujtua të thoshte një fjalë a një mesazh, një ngushëllim publik a një status në fb a twitter. As presidenti, as kryeministri, as kryeparlamentari, as deputetët e Shkodrës, as Bashkia, askush...

Edhe pse dje, realisht, ka ndërruar jetë shqiptari më i madh i globit, e ndoshta, më i shquari personalitet shkencor shqiptar i krejt këtij shekull! Sot, flamuri shqiptar, në të gjitha institucionet tona, duhet të ishte gjysëm shtizë... Sot, presidenti ynë duhet të ishte në Jordani, për të falur xhenazen e Hoxhës më të madh të shqiptarëve. Duhet të ishte edhe kryeministri jomusliman, si vëzhgues e përfaqësues legjitim i vendit tonë, atje! Por, kjo nuk ndodhi. Madje, disa do ta lexojnë me habi këtë shënim anësor... (Dhe, s'kanë asnjë faj, se zakonisht, ata nuk shihen në ceremoni fetare islame... Se nuk e kanë rizk ata, jo ne!)

Por, nga një anë tjetër, asnjëri prej tyre nuk kanë asnjë faj për injorimin e këtij lajmi. Nuk ia kujtoi dikush, qoftë këshilltar, institucion fetar a të ngjashëm, sepse... Sepse, Islami dhe madhështia e tij, tentonet të fshihet sot nga jeta shqiptare, kudo në trojet shqiptare, të minimizohet shfaqja e tij! Është një e vërtetë e dhimbshme!

Sepse ne, muslimanët vegjetojmë kryesisht, nuk reagojmë! Sepse laicizmi ekstremist selektiv islamofob tek ne, sa vjen e nxjerr në pah fytyrat e neveritshme të hipokrizisë me Islamin dhe muslimanët, duke iu përngjasuar shembujve më të neveritshëm të trajtimit që i bëhet Islamit dhe muslimanëve në skutat e errëta e kutërbuese të perëndimit, (jo atij elitar e plot dinjitet)!

Sepse ne, muslimanët shqiptarë, shpeshherë, nuk jemi as për fenë tonë, as për simbolet tona, as për të drejtat tona legjitime!

Për këtë, punohet që ne të shuhemi pak nga pak, ditë pas dite, nën trysninë e imponimeve të mirëorganizuara të shfaqjes së simboleve joislame, tendencave fetare të dala boje të ekspozuara e të stërekspozuara, kudo e çdo ditë!? Pa përmendur islamofobinë e stisur në tërësinë e saj, a osmanofobinë, si alibi e mbrojtjes së dinjitetit kombëtar etj...

Por, ne nuk kemi vdekur akoma! Ezani përhapet çdo ditë në hapësirat qiellore të kësaj toke islame, duke përhapur dritë shprese, bekim të përjetshëm e thirrje hyjnore, të cilës i përgjigjen me tekbire e sexhde, ditë për ditë, me dhjetra e qindra të rinj, në çdo cep të këtij qyteti e krejt trojeve tona...

Me veprimin e tyre, këta të rinj besimtarë e qytetarë elitarë, sikur mbajnë me duar të pastra amanetin e Shejkh Shuajb Arnautit të madh: "Pavarësisht kohërave të errëta që kaloi vendi, duhet që sot, të zgjoheni dhe të ruani amanetin e të parëve tuaj! Qëndroni, mos e leni kte fé! Rune besën e t'parve tuj!"

All-llahu e mëshiroftë Hoxhën tonë të ditur, e bëftë varrin e tij bahçe xhenneti, veprën e tij dëshmi lartësimi në ahiret dhe shembullin e tij frymëzues për zgjimin e brezit të ri të shqiptarëve të pas '90-tës drejt fesë dhe amanetit të brezave të shkuar, gjyshërve e baballarëve, që na mëkuan me shehadet e salavat, me tekbir e ballin në sexhde! Amin!

Shkodër, më 28 tetor 2016

(Hytbeja e mbajtur
në xhaminë e "Dy Vajzave")

NUK KA NGATËRRIM MES AJETEVE...

Ekziston një besë mes Allahut dhe robërve të Tij, ku Allahu thotë: "Kam urdhëruar." Ndërsa besimtarët thonë: "Dëgjuam dhe u bindëm."

Shejkh Muhamed El-Gazali

Nuk lejohet ngatërrimi mes ajeteve, të cilat prezantojnë thirrjen dhe ajeteve mbi ndërtimin e shtetit. Ajetet e para i drejtohen (flasin) një mendjeje bosh, që të njohë Zotin, ku në këtë rast, zakonisht, njeriu është injorant dhe mohues dhe, sapo t'i qetësohet zemra me besim, i themi: Jeta ka parime të tjera dhe obligime të reja!

Kur thirret, ai që është bosh nga Islami, i vjen ajeti: "Dhe, thuaj: E vërteta është prej Zotit tuaj, kështu që, kush do le të besojë dhe kush do le të mohojë"[1], pas dhunë, detyrim, apo imponim në fe. Nëse preferon të vërtetën dhe hyn në besim, i themi: Ekzistojnë detyra të ndryshme, që i presin besimtarët dhe ata duhet t'i kryejnë, si: "O ju që keni besuar, kijeni frikë Allahun dhe thoni fjalë të duhura (të sakta, të drejta)".[2]

Sepse, fjala e duhur, pas zemrës së përkushtuar është baza e moralit të myslimanit. Ashtu siç u thuhet në përgjithësi myslimanëve: "O ju që keni besuar, përkuluni (bëni ruku), bini në sexhde, adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira, që ndoshta ju të shpëtoni".[3]

Shoqëria myslimane është si familje blete, rreth xhamisë, i përgjigjet thirrjes së saj kohë pas kohe duke kryer detyrat ndaj Allahut, ashtu siç kërkohet prej besimtarëve përgatitja për përballje të armikut të tyre dhe rezistencë ndaj sulmit të tij, i cili nuk rend asnjëherë: "O ju që keni besuar, luftoni ata të cilët janë pranë jush prej jobesimtarëve dhe le të gjejnë tek ju ashpërsi".[4]

Ekziston një rrjetë urdhëresash dhe ndalesash, që ruajnë shoqërinë e brishtë dhe forcojnë strukturën e saj, e nuk pranohet prej askujt të neglizhojë, apo të tejkalojë mbi to.

Kam parë disa njerëz, që komentojnë: "kush do le të besojë dhe kush do le të mohojë", kush do falet dhe kush do e lë namazin, kush do dehet dhe kush do rri esëll! Kush do ruan nderin dhe kush do shthuret...

Pra, duan një shoqëri rrëmujë, bosh prej të drejtave dhe obligimeve.

Mikrobi i këtij kuptimi është krijuar në mesin e atyre që e kanë braktisur fenë, të cilët i ka edukuar kolonizatori në vatrën e tij dhe i ka ushqyer pushtimi kulturor me mësimet e veta afetare.

Ky kolonizator, pasi që anuloi dënimet e ndëshkimet dhe mënjanoi sheriatin prej botës së ligjeve, ia mësyu goditjes së akides dhe adhurimeve, moralit të Islamit dhe vlerave të tij! Përhapi mashtrimet e tij në fushat e arsimit dhe të medies, për të krijuar breza bosh, që nuk njohin të mirën dhe as nuk refuzojnë të keqen.

Kemi dëgjuar thirrje perëndimore, që thonë: "Nuk duam Islam politik!"

Po, çfarë doni?

"Duam Islam shpirtëror dhe kaq!"

Në të vërtetë, ata refuzojnë Islamin në tërësi, duke filluar nga Fjala e teuhidit (njësimit) deri te largimi i pengesave nga rruga!

Ata duan një Islam, që lejon imoralitetin, dehjen dhe nuk njeh të drejtën e Allahut në asnjë gjë.

Ekziston një besë mes Allahut dhe robërve të Tij, ku Allahu thotë: "Kam urdhëruar." Ndërsa besimtarët thonë: "Dëgjuam dhe u bindëm."

Prandaj, kushdo që refuzon dëgjimin dhe bindjen ndaj Allahut, nuk quhet mysliman dhe as nuk e pranojmë në rreshtat e besimtarëve!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

1. Kur'ani, El-Kehf: 29.
2. Kur'ani: El-Ahzab: 70.
3. Kur'ani, El-Haxh: 77.
4. Kur'ani, Et-Teube: 123.

ÇALLMA E BARDHË...

Ndër shprehjet e spikatura në ligjëratat e shumta që kam prezantuar para duarve të zotërisë sim, Shejkh Ahmed Keftaro, është edhe kjo, që dua ta ndaj sonte me ju:

"A mundet njeri të thojë për çallmën time të bardhë se, ajo është e zezë? A mund ta mohojë bardhësinë e saj? Natyrshëm që jo! Por, nëse personi në fjalë është në errësirë dhe thotë se ajo është zezë, ai është i justifikuar! Edhe nëse thotë se ajo është jeshile, është i justifikuar!

Sepse, ne nuk ia kemi zbuluar atij të vërtetën, më të cilën sado që të ndeshet, do të mbetet i mundur!"

Kjo urtësi, mendoj se i shkon për shtat krejt konferencave e simpoziumeve, takimeve e seminareve, që organizohen kohëve të fundit për të diskutuar rreth "Islamit paqësor" dhe diferencimit nga ai jo i tillë, ekstremist, politik, kështu e ashtu!?

Në fakt, këto janë pjesë të axhendave të caktuara të qarqeve të caktuara, që punojnë ditë-natë për kompleksimin e muslimanëve në botë dhe shtypjen e vetëdijes së tyre, për të mos u zgjuar kurrë, për të mos u zhvilluar kurrë, për të ngelur përherë të izoluar, në një botë të pambuktë, ku nuk lejohet asnjë pasthirrmë, asnjë lëvizje, asnjë reagim, asnjë fjalë!

Të dashurit e mi, Islami është i pastër dhe i plotë, si çallma e bardhë e Hoxhës, pa njolla, pa komplekse, pa mangësi dhe gjithëpërfshirës!

Me fjalë të tjera, Islami që nisi me "Lexo", është po ai që vijoi me: "Dhe konsultohu me ta", po ai që vazhdoi me: "Luftoni në rrugën e All-llahut ata që ju luftojnë", i njëjti që u zhvillua në: "Dhe, nëse anojnë nga paqja, ano drejt saj!", i njëjti që nxiti drejt: "All-llahu i do të drejtët", po ai që urdhëroi: "Mjerë për ata, që kur peshojnë u hanë hakun njerëzve!", po ai që urdhëroi: "Dhe femra nuk është si mashkulli", po ai që nxiti: "Ju keni fenë tuaj e, unë fenë time!", po ai që urdhëroi: "O ju pasues të Librit, ejani të bashkohemi në një fjalë të vetme: të mos adhurojmë veçse një Zot (All-llahun)!", i njëjti që

tërhoqi vëmendjen e mbarë njerëzimit: "Dhe kur vajzat e gjora të pyeten në ditën e gjykimit: Përse u mbytën për së gjalli?!", po ai që nxit haptas: "E shuan All-llahu kamatën dhe i jep begati lëmoshës!", po ai Islam që urdhëron: "Mos e mbytni veten tuaj!", ose: "Mos iu afroni kurvërisë!", ose: "O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar!", po ai që porosit: "Mos e harroni mirënjohjen në mes jush!", i njëjti që betohet: "Pasha Lapsin...", ose ai që urdhëron: "Dhe rrobat tuaja pastroji!", ose: "All-llahu i do të pastrit", "Hipokritët janë fund të xhehnemit!", ose: "Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi..!", etj, etj pa fund!

Prandaj, mos u kompleksoni nga thirrjet dhe propaganda e copëtimit të Islamit, por shijojeni maksimalisht bekimin e All-llahut mbi ju, faktin që jeni MUSLIMANË!

Do të vazhdojmë të bëjmë konferenca e takime, simpoziume e organizime, vetëm me një qëllim: t'i themi kujtdo se, çallma e bardhë nuk është e zezë! Kush e sheh ndryshe, të dalë nga biruca ku është fshehur dhe të shohë dritën e diellit!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

"Në ligjin e Allahut dhe praktikën e Tij: Liria me dhimbje është më fisnike për njeriun se sa skllavëria me lumturi. Për këtë arsye na ka lënë të qabojmë, të ndiejmë dhimbje dhe të mësojmë. E kjo është urtësia në lejimin e Tij të së keqes".

Dr. Mustafa Mahmud

INTERVISTË ME HIRËSINË E TIJ, SHEJKH SHUAJB ARNAUTI

(kjo intervistë ribotohet me shkas dhe është botuar për herë të parë në "Udha Islame", nr. 133 - Mars 2014)

Fillimisht, kemi dëshirë të njohim biografinë e jetës suaj, ku keni lindur, rritur, shkolluar dhe cilët kanë qenë mësuesit (shujukh) tuaj etj:

Jam rritur si nxënësit e tjerë të diturisë, ku dituria mu bë e dashur për mua. Punoja në tregun Saruxha në lagjet e vjetra të Damaskut dhe në dyqanin tonë pas dreke (iqindisë) na vizitonte një dijetar (shejkh). Njerëzit e kishin traditë që në këtë kohë nuk punonin dhe pushonin. Ky dijetar vinte te ne për hir të Allahut dhe na mësonte rregullat e gjuhës arabe. Krahas kësaj na mësonte edhe Sherhul kenz të Shejkh Abdulhakim El-Afgani (r.h) dhe El-Hashijetu. Të dy këto libra i kam mësuar prej këtij dijetari, Allahu e mëshiroftë.

Gjithashtu kam mësuar prej Shejkh Salih Farfurit disa libra: Tefsir En-Nesefij, Sherhul Menar në Usul, Sahihul Muslim, librin e Buharit të Ajniut (r.h), Umde. Krahas këtyre librave kam mësuar prej tij edhe metaforë, Sherh Ibn Akil, dhe filozofi, si filozofia e Suriut, e cila sot nuk ka më vlerë.

Prej mësuesve të mi janë edhe: Shejkh Sulejman Gavoçi, i ati i Vehbi Sulejman Gavoçit. Kam mësuar gramatikë (nahv) sipas metodës osmane, ku fillohej me avamil, me idhhar të Berxhuvisë, pastaj "El-Kafijete" të Ibn Haxhib, e cila ishte e njohur dhe e përhapur në Lindje. Kam lexuar "Merakil-Felah" dhe "Hashije" të Tahaviut. Gjithashtu kam mësuar nga babai i Shejkh Nasir Albanit librin e fikhut Hanefi të Ebul Hasen El-Kudurit, i cili është libër reference prej librave të medhhebit Hanefi. Kam mësuar prej tij edhe mesele shkencore, ku për tre vjet që qëndrova te ai, unë pyesja dhe ai më përgjigjej, Allahu e mëshiroftë. Pra, dituria m'u bë shumë e dashur.

Pasi mbarova tetë vjet shkollë m'u lejua të punoja mësues në institutin "El-Feth el-Islami", i cili përfshinte një numër të madh studentësh, nga


SHEJKH SHUAJB ARNAUTI

Vëllezërve të mi, të cilët janë kujdestarë të kësaj faqe mos shkruani, veçse ato gjëra që keni dëshirë t'i shikoni në ditën e kiametit dhe ju bëjnë të qëzuar në atë ditë. Duam që njeriu të mos treqohet sektarist, të ngrejë dikë, e të poshtërojë dikë tjetër. Dua që ata të kenë gjithmonë qëllimin e arritjes tek e vërteta dhe angazhimit në metodën e saktë, në të cilën kanë ecur dijetarët dhe imamët, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

shkolla e mesme dhe ajo e lartë, gjithashtu edhe master. Ata studentë që dëshironin të vazhdonin edhe doktoraturën shkonin dhe e plotësonin në Egjipt. Këtu qëndrova dy vjet duke i mësuar studentëve shkenca islame dhe ato të gjuhës arabe.

Pastaj, me formimin e kushteve iu drejtova me kënaqësi studimit të Trashëgimisë Profetike. U thellova shumë në këtë rrugë duke absorvuar librat e Mustalahit (shkenca e terminologjisë së hadithit) si: "Mukaddime Ibn Salah", "Taudih el-efkar lil-San'ani", "Sherh en-nukhbeti l-Ibni Haxher". Kështu fillova dhe gjithmonë e lusja Allahun (xh.sh) të më bënte në grupin e hadithologëve (dijetarëve të hadihti). Desh Allahu e ma pranoi lutjen time dhe kështu vazhdova në këtë rrugë; që 40 vjet e deri tashi unë redaktoj libra, jap shkencën e hadithit dhe kam nxjerrë (redaktuar) më shumë se 200 vëllime rreth kësaj teme.

Shumë herë dëgjojmë lart e poshtë se interesimi për Senedin (vargun e transmetuesve) ka mbaruar dhe nuk është e nevojshme të merresh me të, por në të njëjtën kohë shohim të tjerë që janë zhytur në të, madje deri edhe te Senedi (vargu i transmetuesve) të Buhariut dhe Muslimit, në studimin e tyre dhe gjykimin për to, prandaj cili është mendimi juaj për këtë?

Dua të them se mendimi im për studimin e Senedit (vargut të transmetuesve) akoma është çështje interpretimi (ixhtihadi) ... Vendimet nuk janë përgjithësuese, sepse çdo njeri kur merret me studimin e Senedit ka të bëjë me bindjen e tij rreth atij hadithi që ka marrë në studim. Po qe se arrin në ndonjë përfundim, ndoshta në sytë e të tjerëve mund të jetë i gabuar, ose mund të jetë i saktë për sytë e disa të tjerëve. Për këtë, El-Mundhiri ka shkruar një libër, në të cilin ka sqaruar se gjykimi (vendimi) për hadithet është gjykim ixhtihadij (interpretativ) që është i lidhur me bindjen e studiuesit, aftësinë dhe zotësinë e tij, të cilat ka arritur t'i fitojë për një kohë të gjatë si dhe gjatë praktikës së studimit të Senedeve (vargjeve të transmetuesve).

Për sa i përket pyetjes se studimet e Senedeve kanë përfunduar, mund të them se: Studimet e Senedeve (vargjeve të transmetuesve) kanë treguar plotësisht interes, ku unë jam njëri prej atyre që kanë punuar në këtë fushë. Ka edhe profesorë të tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në studimin e Senedeve duke i dhënë hakun kësaj fushe. Dhe, duke u nisur nga grumbulli

i punëve të tyre dhe i punës sime them që 90% e Trashëgimisë Profetike është redaktuar nga ana e Senedit (vargut të transmetimeve) dhe është dhënë vlerësimi për të.

Ndërsa, për sa i përket *nakdul-meten* (kritikës së përmbajtjes së hadithit), pa dyshim dhe pa asnjë mëdyshje në shkencën e hadithit, kur dikush studion Senedin, patjetër duhet të studiojë edhe Metnin (teksti i hadithit). Sepse, hadithin e saktë e kanë përkufizuar si hadith ku transmetuesit e tij janë të saktë dhe të përpiktë... etj. E kanë përkufizuar që të mos jetë i veçuar (shadh), apo i parregullt, sepse veçansimi dhe parregullsia janë pjesë e kritikës së përmbajtjes (metnit) dhe vargut të transmetuesve (senedit). Si shembulli i këtyre gjërave, e them shkoqur se nuk mundet njeri ta arrijë këtë nivel, përveç se pas një mundi të madh, praktike të gjatë, zotësie shtesë dhe devotshmërie ndaj Allahut (xh.sh), e cila e mbron studiuesin që të mos devijojë nga rruga e drejtë. Për këtë unë sugjeroj, që për kritikën e përmbajtjes (metnit) duhet të mblidhen një grup dijetarësh! Dua të them: Të krijohet një këshillë shkencor për të studiuar përmbajtjen e hadithit (metnin) dhe t'i vlerësojë ato. InshaAllah do të jetë ky mendim i drejtë, sepse grupi, në dashtë Allahu është më tepër i saktë (i drejtë) se sa mendimi i një personi të vetëm, veçanërisht për këto gjëra.

Dy libra rreth shkencës së hadithit (El-Xherh vet-teadil): "Tehdhibul-kemal" të Imam El-Mizzijut dhe "Et-Tehdhib" të Ibn Haxher El-Askalaniit, cila është rëndësia e këtyre dy librave për punonjësin e redaktimit? Dhe, a mund të mjaftohet vetëm me njërin prej tyre?

Ai që punon në shkencën e hadithit (el-Xherh vet-teadil) e ka shumë të domosdoshme të ketë librin "Tehdhib ul-kemal", sepse transmetuesit disa herë vijnë kështu: Muxhahid, por kush është Muxhahidi? Kur kthehet te libri "Tehdhibul-kemal" i Hafidh El-Mizzijut, aty do të gjejë të gjithë mësuesit dhe nxënësit, të cilët kanë transmetuar prej këtij njeriu që e ka emrin Muxhahid. Kështu që, pas kësaj, ai mund ta përcaktojë se kush është personi, prandaj është shumë e domosdoshme ta ketë këtë libër. Libri "Tehdhibul-Kemal" ka përfshirë "gjashtë librat"[1]. D.m.th të gjithë mësuesit e transmetuesit, të cilët kanë transmetuar prej tij, hadithet e tyre në "gjashtë librat" dhe nxënësit e tyre janë të përmendur në biografitë e secilit prej tyre. Kjo është një gjë shumë e madhe! Pastaj, Imam Mizziu (Allahu e mëshiroftë) transmeton nga dijetarët e hadithit (El-Xherh vet-teadil) thëniet e tyre dhe ndonjëherë edhe i vë në peshore mendimet e njëri-tjetrit. Prandaj, patjetër që studiuesi duhet t'i grumbullojë këto thënie, të cilat janë thënë për transmetuesin, e më pas t'i studiojë, t'i peshojë dhe të arrijë në përfundimin e duhur.

Ne e kemi shqyrtuar El-Hafidh Ibn Haxher dhe ndoshta kemi për të, rreth një mijë komente, d.m.th gati çerekun e librit e kemi plotësuar për të (Allahu e mëshiroftë). Këtë punim do ta gjesh në librin me titull: "Tahrirut-takrib.

Ndërsa libri i El-Hafidh Ibn Haxher është përmbledhje e librit "Tehdhibul-kemal, ashtu siç e ka thënë edhe vetë autori në parathënien e librit.

Te disa nxënës të dijes është përhapur interesimi për gjykimin ndaj hadithit, i saktë (sahih), apo i dobët (daif) dhe nxënësit e dijes që punojnë në redaktim tregojnë rëndësi të përmendin hadithin, a është i saktë, apo i dobët. Cili është mendimi juaj për këtë? A ka ndonjë metodë që nxënësit e dijes duhet ta ndjekin, për gjykimin (vlerësimin) e hadithit?

Këta njerëz të vlerësojnë (gjykojnë) pasi t'i kenë plotësuar mjetet kërkuese, por nuk duhet t'i shkruajnë në libër, përveç se kur kritika t'i bëhet zotësi, me të cilën munden të dallojnë të saktën dhe jo të saktën. Natyrisht, në qoftë se personi nuk i shikon punimet e atyre që kanë qenë përpara tij, ai nuk do t'ia qëllojë aspak kësaj pune! Duhet patjetër t'i kthehet thënieve të hadithologëve dhe imamëve të vjetër dhe sidomos në hadithet, për të cilat ka mospajtim, t'i studiojë me seriozitet, pastaj t'i vlerësojë (gjykojë) sipas mendimit të tij. Kjo, kështu është dhe nuk ka rrugët tjetër! Ndërsa të njohë vetëm diçka prej Musatalahit (shkenca e terminologjisë së hadithit), të lexojë disa libra shkencorë dhe t'ua tregojë ato njerëzve, kjo gjë bënë më shumë keq, se sa mirë!

Qarkullon te disa të ditur se dy librat e saktë të Buhariut dhe Muslimit kanë të meta, duke u argumentuar se në to ka hadithe "të varura" (mualeka) dhe "të veçuara" (shadhë). Cili është komenti juaj për këtë?

Këto fjalë nuk kanë asnjë grimcë shkencore. Libri "Sahih" i Buhariut

Duhet ta dinë mirë të gjithë nxënësit e dijes,

pa përjashtim se hadithi është njëri prej burimeve

në të cilat mbështetet interpretuesi (muxhtehidi).

Kur'ani është i pari, pastaj Suneti, Konsensusi dhe Analogjia.

Këto janë shkallët në të cilat kanë shkelur dijetarët të gjithë, pa përjashtim.

Kështu që, Fakihu (juristi) patjetër duhet të jetë haditholog (muhadith),

të jetë komentues (mufesir), të jetë usulist dhe jurist,

në mënyrë që t'i përdorë këto katër burime dhe të tjera burime si:

El-Maslahatu el-mursiletu, El-Istihsan, sheriatet e atyre

që kanë qenë përpara nesh ... e të tjerë.

1. Gjashtë librat në hadith "Kutubus-Sitte" janë: Librin i Buhariut, libri i Muslimit, libri i Nesaiut, libri i Tirmidhiut, libri i Ebu Davudit dhe libri i Ibn Maxhes.

(Allahu e mëshiroftë), them për të çfarë ka thënë Abdulgani El-Makdesi: "Sikur një njeri të betohet për divorc, se hadithet e Buhariut janë të gjitha të sakta, në varg transmetimi (musnede) dhe pa këputje në zinxhirin e transmetuesve, divorci për të nuk vlen." Sepse Imam Buhariu, pa asnjë dyshim dhe mëdyshje, të gjithë hadithet e tij në këtë libër i ka të saktë, edhe ai e konfirmon prerazi këtë. D.m.th: Kjo sipas bindjes së tij, të gjitha hadithet e lidhura (musnede - të pa shkëputura në vargun e transmetuesve), të cilat i ka sjellë në librin "Es-Sahih" të tij, ato janë të sakta. Por, nëse dikush vjen pas tij dhe e kundërshton, kjo gjë është mospajtim interpretuesish në varësi të disa haditheve, të cilat janë kritikuar ndaj Imam Buhariut.

Unë mendoj se nxënësi i dijes duhet gjithmonë dhe përherë t'i shikojë hadithet e Buhariut dhe të mjaftojë me atribuimin e tij, sepse atribuimi i tij është tregues i saktësisë! Kritika që i drejtohet Buhariut është kritikë që nuk ka lindur nga dituria. Nëse e lexon parathënien e "Fet'hul-Barit" për hadithet, të cilat pretendohen ndaj Buhariut se ato janë të dobëta në vargun e transmetuesve (sened), apo flitet për transmetuesit e tyre, do ta shikosh se si autori i këtij libri e mbron saktësisht Imam Buhariun.

Po, vetë Buhariu në disa herë sjell hadithe "merfua", pastaj i transmeton "meukufe" për të treguar se hadithi "meukuf" është i saktë sipas mendimit të tij. Ai në këtë libër ka interpretimet e tij, që duhet patjetër të dihen. Unë them atë që dijetarët kanë thënë: "Pas librit të Allahut (Kur'anit) nuk ka libër më të saktë, se sa libri "*Sahih i Buhariut*!"

Ndërsa libri i Muslimit është në një shkallë më të ulët, por Muslimi në librin bazë transmeton hadithe të sakta, e më pas në verifikim tregohet lehtësues.

Në qoftë se një hadith transmetohet me Sened (varg transmetuesish) të saktë, pastaj vjen në një rrugë të dytë, të tretë dhe të katërt i njëjti hadith, por rruga ka dobësi të vogël, ai (Muslimi) e sjellë atë, sepse në Mutabeatë dhe Shevahid e përmend këtë gjë.

Kemi dëshirë, Hoxhë i nderuar të na sqarosh metodën më të saktë në sjellje me personat, për të cilët dijetarët e hadithit (El-Xherh vet-Teadil) nuk kanë folur për ta, pra nuk kanë dhënë ndonjë opinion rreth tyre, d.m.th kanë heshtur për ta?

Për ata, të cilët nuk është folur rreth tyre, patjetër duhet që hadithet e tyre të analizohen, sidomos hadithet në Musnedin e Imam Ahmedit. Në qoftë se gjejmë një transmetues, ndaj të cilit nuk është folur, por prej tij kanë transmetuar më shumë se tre-katër persona dhe askush nuk i ka mohuar këto transmetime prej tij, atëherë hadithet e tij i quajmë "Hasen" (të mira), që do të thotë se ato vlejnë si argument, përveç në ato raste kur këto hadithe kundërshtohen prej ndonjë hadithi të saktë e të pa shkëputur (musned).

Cila është metoda juaj për transmetuesit ndaj të cilëve ka mendime të ndryshme (xherhan ve teadilen)?

Të them të drejtën, ne kemi mësuar nga librat e shkencës së hadithit (El-Xherh vet-Teadil) se disa njerëz janë strikt dhe disa të tjerë janë lehtësues. Kështu që, gjejmë transmetues (ravi) që, sado që të jetë i besueshëm (thikât), në disa raste sjell ndonjë hadith, i cili është i mohuar (munker). D.m.th deri edhe transmetuesit e besueshëm (thikât), të cilët janë transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Pra, nuk ka njeri që mund t'i shpëtojë gabimeve, sado që mundohet të jetë i përpikët. Për këtë, edhe Imam Shafiu thotë: "Të besueshëm (thikât) për ne quhen ata njerëz që janë shumë të saktë dhe gabojnë pak dhe, të dobët (daif) për ne janë ata njerëz që gabojnë shumë dhe janë pak të saktë." Mbi këtë bazë ne ecim dhe këto i gjen te libri "Tahrirut-tekrib", të sqaruara në mënyrë të qartë dhe të hollësishme. P.sh kur refuzojmë Hafidh Ibn Haxher që thotë për ndonjë transmetues (ravi): I drejtë (saduk), unë them: I besueshëm (thikât), e ka bërë të besueshëm (veth-thakahu) filani, filani e filani. Pra, kur shohim se grupi i dijetarëve të mëdhenj e të përpiktë e kanë bërë të besueshëm (veth-thaku) atë transmetues, atëherë ne nuk i kushtojmë rëndësi fjalës së Ibn Haxherit, i cili në këtë rast e ka tejkaluar të vërtetën (nuk ia ka qëlluar).

Keni punuar për redaktimin e librit "Sahih" të Ibn Hibanit, a mund të na jepni një përmbledhje të shkurtër rreth metodës së Ibn Hibanit për librin e tij?

Metoda e Ibn Hibanit në librin e tij është e ndryshme prej metodës, të cilën ai ka ndjekur për librin e tij: "Të Besueshmit" (Eth-thikât).

Së pari: Hadithet e Ibn Hibanit janë të shumta, përveç 2050 hadithe, ose afërsisht me këtë numër, të gjitha i ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi dhe autorët e tjerë të librave të saktë. Por, ai transmeton përmes mësuesve dhe dijetarëve të tij, prej të cilëve ka transmetuar. Ndërsa hadithet, të cilat ai nuk i ka shqyrtuar, por ato i kanë shqyrtuar autorët e Suneneve, metoda e tij është metoda e librit të Saktë (Sahih). Këtë e kam mësuar gjatë praktikës, sepse unë i kam studiuar të gjithë transmetuesit. Ndërsa, dijetarët prej të cilëve ka transmetuar, ata janë të gjithë të besueshëm (thikat). Ai ka arritur të njohë më shumë se dy mijë dijetarë dhe është përqendruar te 200 prej tyre në librin e tij të Saktë, të cilin e ka mbështetur te këta transmetues që i ka bërë vetë të besueshëm (veth-thakahum) dhe i ka njohur cilësitë e tyre. Në parathënien e këtij libri, unë kam dhënë biografitë e tyre dhe i kam vendosur në gradën e vet secilin, të besueshëm (thikat), apo të dobët (daif).

Dhe për sa i përket transmetuesve, të cilëve Ibn Hibani ua ka saktësuar hadithet e tyre, disa hadithe të paktë në numër, nuk është rregulli dhe tradita e Ibn Hibanit t'i bëjë të besueshëm (teu-thîk) njerëzve të panjohur. Kjo nuk është metoda e tij dhe konsiderohet si kontradiktore e metodës së librit Të Saktë të tij. Në librin e Saktë të tij nuk gjen asnjë prej atyre personave, të cilët i ka bërë të besueshëm dikush tjetër, përveç autorit, shumë shumë pak. Pjesa tjetër, të gjithë janë prej atyre që i kanë bërë të besueshëm (veth-thakahum) të tjerët, përveç Ibn Hibanit. Për disa prej tyre ka folur ndonjë diçka të vogël, d.m.th ai (libri) qëndron shumë më lart se sa Mustedreku i Hakimit dhe

NË GJURMËT E HOXHËS TONË, SHEJKH SHUAJB ARNAUTI...

Po dëgjoj me kënaqësi dhe mall, një bashkëbisedim të gjatë të Hoxhës tonë rahmetli, Shejkh Shuajb Arnauti, me një grup studiuesish pranë Qendrës "El-Karadavi" për Mesatarizëm dhe Përtëritje, në Doha të Katarit, dy vite më parë.

– Një nga studiuesit e pranishëm, e pyet Hoxhën: "Në lidhje me verifikimin që i keni bërë "Musnedit" të Imam Ahmedit (50 vëllime), a i ka lexuar Hirësia e juaj të gjitha hadithet e tij?"

Hoxha, duke buzëqeshur ia kthen: "Po, pasha All-llahun, betohem në All-llah, se me mua kanë punuar disa persona, 10-15 veta, të gjithë prej nxënësve të mi. Por, unë isha i vetmi që e kam lexuar "Musnedin", nga elifi i tij deri tek ja-ja e tij! (Nga a-ja e tij deri tek zh-ja e tij)

Inshallah, unë e kam frikë All-llahun! Nuk mund të them me gjuhën time se e kam bërë diçka, nëse nuk e kam bërë! Përndryshe do të isha gënjeshtar!?

Duhet të kem frikë nga Zoti i botëve, para se të kem frikë nga njerëzit!"

– E pyet një studiues algjerian se çfarë lidhje ka me Shejkh Abdulkadir Arnautin, sepse dikush mendon se janë vëllezër gjaku.

Hoxha, teksa buzëqesh, ia kthen: "Abdulkadir Arnauti është nga Kosova, ndërsa unë jam nga Shqipëria. Të dy kemi lindur në vitin 1928, ndërsa ai ka shkuar tek All-llahu, para meje!

Ishte njeri i mirë, i ditur, i përkushtuar. Ka spikatur më shumë në vaset e tij, sesa në verifikime shkencore.

Madje Shejkh Hasan Habenneke, kur e shihte në ndonjë mexhlis, i thoshte: "Ngrihu, o Hoxhë, na jep vasë!". Sepse ai, rahmet pastë, ndoshta dinte përmendësh dy mijë hadithe të sakta, mashallah... Edhe Kur'anin, edhe pse nuk e dinte përmendësh, por kur mbante vasë a hytbe, sillte 15 a 20 ajete..."

Rahmet pastë...

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Muhamed B. Sytari

gjithashtu edhe më lart se Sahihu (libri i saktë) i Ibn Khuzejmes. Sepse Ibn Khuzejme ka sjellë në librin e tij disa hadithe, madje shumë hadithe për të cilat akoma pa mbërritur në çerekun e librit, thotë: "Në qoftë se lajmi (haberi) është i saktë." Ibn Hibani është krejt i pastër prej këtij lloji hadithesh.

Në fund të takimit, kemi dëshirë që lexuesve të faqes sonë, t'u japësh disa këshilla, Allahu (xh.sh) ta shpërbleftë me të mira, të dhashtë begati dhe diturinë e punën tuaj ta bëftë në peshoren e veprave e përfitoftë sa më shumë Islami dhe myslimanët prej kësaj pune.

Vëllezërve të mi, të cilët janë kujdestarë të kësaj faqeje mos shkruani, veçse ato gjëra që keni dëshirë t'i shikoni në ditën e kiametit dhe ju bëjnë të gëzuar në atë ditë! Duam që njeriu të mos tregohet sektarist, të ngrejë dikë, e të poshtërojë dikë tjetër. Dua që ata të kenë gjithmonë qëllimin e arritjes tek e vërteta dhe angazhimit në metodën e saktë, në të cilën kanë ecur dijetarët dhe imamët, (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Këtë gjë dëshiroj prej tyre dhe të jetë devotshmëria ndaj Allahut, motivi kryesor që i shtyn drejt këtij qëllimi.

Këshilla juaj për nxënësit e dijes?

Duhet ta dinë mirë të gjithë nxënësit e dijes, pa përjashtim, se hadithi është njëri prej burimeve në të cilat mbështetet interpretuesi (muxhtehidi). Kur'ani është i pari, pastaj Suneti, Konsensusi dhe Analogjia. Këto janë shkallët në të cilat kanë shkelur dijetarët, të gjithë, pa përjashtim. Kështu që, fakihu (juristi) patjetër duhet të jetë haditholog (muhadith), të jetë komentues (mufesir), të jetë usulist dhe jurist, në mënyrë që t'i përdorë këto katër burime dhe të tjera burime si: El-Maslaha, El-Istihsan, sheriatet e atyre që kanë qenë përpara nesh etj.

Nuk i lejohet asnjë njeriu të mbështetet vetëm te hadithi, pa u kthyer te Kur'ani i madhërishëm, pa u kthyer te ajo që kanë thënë sahabet e nderuar, (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre), për këtë hadith dhe si kanë vepruar me të. Libri më i mirë si pikë referimi për këtë gjë është libri: "Musannaf Ibn Ebi Shejbe", "Musannaf Abdurrezak" dhe "Sunen Said ibn Mensur". Këto tre libra përmendin mendimet e sahabëve dhe tabiinëve rreth hadithit që transmetojnë për një temë të veçantë.

(intervistë e zhvilluar nga faqja e internetit: www.alssunnah.com
Intervistoi: **Selman El-Hursh***)*
Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

PIKA TE ARTA PËR UDHËZIMIN E NJERËZISË



Shejkh Vehbi S. Gavoçi

PIKA TE ARTA PËR UDHËZIMIN E NJERËZISË

Ka ardhur në Hadith të Muslimit se një sahabi e pyeti Profetin (a.s): Pse agjëron ditën e hënë?

Profeti (a.s) iu përgjigj: "Ajo është dita që unë kam lindur në të". Me të vërtetë ai Zotëri ka lindur ditën e hënë, është zgjedhur Profet ditën e hënë, ka emigruar dhe ka ndërruar jetë ditën e hënë.

Shohim se ai Zotëri (a.s) përmendi ditëlindjen e tij dhe na mësoi me e ditë atë ditë të bekuar.

Para qindra vjetësh dhe deri sot Ulematë në Hadith, Tefsir, Fikh etj, e kanë festuar dhe e festojnë ditëlindjen e Profetit (a.s).

Kanë lexuar jetën e Profetit (a.s) në disa faqe të zgjedhura. Kanë lavdëruar cilësitë e tij, siç e ka lavdëruar Hassani përpara vetë Profetit (a.s), kanë rënë salavatë mbi Pejgamberin (a.s) me qindra herë, mandej dikush ka shtruar sofra, kanë bërë gosta prej gëzimit me këtë rast të vlefshëm, që me të Zoti (xh. sh) ndriçoi jetën e besimtarëve dhe botërave krejt, mbasi ai zotëri është dërguar mëshirë për gjithësinë.

Disa guxojnë e thonë çka nuk thuhet, gjoja, mbasi vetë Profeti (a.s) as sahabët, krejt ata nuk kanë festuar ditëlindjen e Profetit (a.s), atëherë ajo festë është e ndaluar fetarisht. Ata vetë duhet me e ditë përpara të tjerëve, se *mos bërja e Profetit (a.s) ose sahabëve të një gjëje, ajo nuk është vendim deri sa të dihet shkaku,* mundet me qenë e ndaluar si p.sh. me u përulë deri në tokë përpara Profetit (a.s) ose kujt tjetër, mundet me qenë e lirë ose e lënë nga ai zotëri për të mos e rënduar popullin me disa kërkesa, si teravinë në Ramazan...

Le të lexojmë këtë ngjarje si shembull: Kur Hz. Ebu Bekri dhe Hz. Omeri vendosën me i mbledhë ajetet e Kur'anit të përhapura në disa papiruse, lëkura, gurë e eshtra, që u shkruan në to, siç urdhëronte Profeti (a.s), thirrën Zejdin, djalin e Thabitit e i thanë: Ti i ke shkruar ajetet e Kur'anit në prani të Profetit (a.s), je djalë i ri, nuk akuzohesh pra, mblidhi ato ajete të ndara, në një vend, që të mos humbë gjë. Zejdi u përgjigj: "Si mundet të bësh një gjë që nuk e ka bërë Profeti (a.s)?". Ata i thanë: Kjo është një gjë e mirë, derisa Zejdi e pa të vërtetën në punën e tyre, atëherë pranoi dhe pëlqeu me e ba atë punë, mbasi ishte për mbrojtjen e vetë Kur'anit.

Dijetarët mbas sahabëve regjistruan jetën e Profetit (a.s) e formuan libra të veçantë, regjistruan Hadithet e Profetit (a.s) e formuan bibliotekën më të madhe në botë, me qindra tema e subjekte. E ndanë Kur'anin e Madhnueshëm në 30 xhyze (pjesë), i vendosën zanore e pika disa germave, e të tjera gjëra, të cilat nuk kanë ndodhur në kohë të Profetit (a.s) e as të sahabëve.

Nuk thuhet se ato sende nuk bën me u ba, por bën dhe duhet të bëhen mbasi janë gjëra që shtojnë dijen, e lehtësojnë atë dhe i shërbejnë Kur'anit të lexohet lehtë, të kuptohet, etj. Ata që guxojnë me thënë, që atë gjë nuk e ka bërë ose pëlqyer Profeti (a.s), është haram, ata gabojnë, flasin pa fakte e dogma.

Ata duhet të përmendin se ne kur të festojmë ditëlindjen e Profetit (a.s) nuk themi se është farz ose obligim, apo është synet, ne themi ajo është gjë e mirë, gjë e dashur e gjë e pëlqyer. Thotë Abdull-llahu, djali i Mesudit: "Ç'ka shohin muslimanët se është e mirë ajo gjë është e mirë". Thotë Profeti (a.s): "Ymeti im nuk bashkohet në humbje". Bile vetë Ibni Tejmije, në librin e tij "Iktidaus-siratil mustekimë", thotë se është mirë me festu ditëlindjen e Profetit (a.s), siç kanë thënë Ulematë e siç përmendëm përpara, por jo me u përzi gra e burra e me ba çfarë nuk pëlqen feja në atë ditë ose në ato festa.

Po përmendi këtë tregim: Para disa vjetësh kur ishte Princi i Xhides në Arabi Saudite i mbledhur me disa Ulema të vendit, njëri prej tyre kërkoi leje për t'u larguar. Princi pyeti: "Përse po largohesh?". Dijetari u përgjigj: Më duhet të shkoj në Riad, se kemi javën e festës, për javën e Abdulvehabit. Qeshi princi e tha, por i mërzitur: "Ju nuk lejoni me festu siç feston bota Islame jashta qeverisë tuaj një ditë ditëlindjen e Profetit Muhammed (a.s), kurse festoni jetën e atij njeriu një javë?"

Njeriu zakonisht është fjalë e sjellje bashkë, sado të jetë fjala e matur e ëmbël, dhënëse, pasanike dhe e dashur, sado të jetë e saktë dhe e drejtë, ajo kur nuk vërtetohet me sjellje e nuk lidhet me zbatim mbetet fjalë e ëmbël, mirëpo "fjala nuk mbush bark", si kanë thënë, në qoftë se i kënaq njerëzit një herë nuk i kënaq përherë.

Shumë kanë lexuar e dëgjuar njerëzit fjalë, herët a vonë, e kur nuk kanë zbritur ato fjalë në tokën e zbatimit, kanë mbetur fjalë, dhe shpesh ato fjalë kanë rënë me të zotin e tyre nga syri i njerëzisë. Le të bashkojmë e të vërtetojmë sot, me rastin e muajit të lindjes së Profetit (a.s) këtu disa fjalë të Tij (a.s) në lidhje me sjelljet, por me pak shembuj.

1. Profeti (a.s) ftoi njerëzinë të besojë në Krijuesin e gjithësisë në një vend e kohë, në të cilin u harrua besimi i saktë në Zotin (xh.sh) dhe kur u ngushtua aq tepër nga presionet femohuese, Profeti (a.s) i tha xhaxhait të tij, Ebu Talib: "Të më vënë diellin në dorën e djathtë e hënën në dorën e majtë që ta lë këtë "MISION" e "THIRRJE" s'e lë kurrë deri sa të vdes, ose të triumfojë kjo "THIRRJE" e "MISION". Dhe qau si qajnë burrat në zori. Këtu xhaxhai i prekur nga fjalët e nipit e këmbëngulja e tij, tha: "O nipi im, puno si të duash, unë nuk të dorëzoj kurrë".

2. Na tregon ish çifuti, Abdull-llah, djali i Selamit e thotë: Kur erdhi Profeti (a.s) në Medine, iu mblodhën sahabët e tha: "Hapni përshëndetjen ndërmjet jush (selamin) dhe ushqeni të tjerët, faluni në terrin e natës, hyni në xhennet me paqë". Sa herë ai Zotëri ka ndaluar veten e vet nga ushqimi për me iu dhënë të tjerëve.

I erdhi një herë një njeri dhe kërkoi prej tij çfarë nuk kishte. Dhe Profeti (a.s) i tha: "Shko e merr hua në emrin tim tek filani, kur të kem ia kthej unë huanë".

Fali iqindinë një ditë, mbas faljes u çua shpejt, hyri në shtëpinë e tij, mbas pak u kthye. E pyetën sahabët se pse u largua mbas faljes aq shpejt? Profeti (a.s) ua ktheu: "Më ra ndër mend se

kisha disa para në shtëpi, pra nuk u rehatova deri sa i ndava ato".

3. Ka fol Profeti (a.s) shumë Hadithe për me fol e me punu me të drejtën. Një ditë mblodhi të afërmit e vet e iu tha: "Prijësi nuk i gënjen njerëzit e vet, sikur të gënjeja këdo, nuk ju gënjej ju, në qoftë se mashtroj këdo, nuk ju mashtroj ju, pra dëgjoni: Keni me vdekë ashtu siç flini, keni me u ringjallë ashtu siç çoheni nga gjumi, mandej mbas kësaj jete, është xhennet përherë ose zjarr përherë". Dhe, kur i foli për herë të parë popullit të Mekes, u tha: "Sikur t'u them se armiku i është afruar Mekës e do të na luftojë, a do të më besoni?". U përgjigjën: Po, sepse prej teje nuk kemi provuar gënjeshtra! Këtu tha përsëri: "Unë jam frikësues[1] i juaji përpara gazepit të madh".

4. Ka folur Profeti (a.s) shumë Hadithe, për mbajtjen e fjalës. Kur Profeti (a.s) bëri traktatin e paqes me idhujtarët kurejshi të Mekës, për ta ndaluar luftën për 10 vjet ndërmjet tyre. Një prej kushteve ishte se ai që ikë nga Medineja për në Mekë, d.m.th. e lë fenë, nuk detyrohen idhujtarët me e kthy në Medine, kurse në qoftë se ikë nga Meka në Medine, d.m.th. bëhet musliman, detyrohen muslimanët me u kthye në Mekë.

Pas vënies së firmës së atij traktati erdhi një burrë me pranga në duar, ku kishte ikur nga burgu i babait të vet pse kishte pranuar Islamin. U gëzuan muslimanët kur e panë, kurse babai i tij kërkoi me e kthye në Mekë dhe Profeti (a.s) vendosi me e kthy dhe e ktheu, kurse atij i tha: "Duro, fundi është i mirë".

5. Zemra e gjerë, bamirësia e Profetit (a.s) përmendet në shumë raste, falja e disa armiqve përmendet, por në pak raste dhe në pak njerëz, por kurrë nuk arrin me qenë si mirësjellja e Profetit (a.s). Kur iu dorëzua Meka pa kushte, mekelitë (banorët e Mekës) shkuan në shtëpitë që kishin në Mekë, kurse Profeti (a.s) qëndroi në çadër me ata që nuk kishin shtëpi në Mekë.

Disa sahabë i thanë: Pse nuk shkon në shtëpinë tënde? lu përgjigj: Djemtë e xhaxhait më kanë grabitur shtëpinë". Dhe kur u mblodh paria e Mekës me popull, urdhëroi e tha: "Çfarë kujtoni se do të bëj me ju?". Doli një i urtë e tha: "Vetëm mirë, ti je vëlla besnik e nip besnik". Tha ai zotëri me kënaqësi: "Shkoni ku të doni, jeni të falur e të lirë".

1.Ka për qëllim: Jua tërheq vëmendjen për një ditë, e cila është shumë e frikshme, dita e kiametit.

GUXIM

1. Deri në shekullin e 14 (kalendari Islam), nuk kam lexuar as nuk kam dëgjuar se një dijetar ka shkruar libër për falje e ka thënë: "Kështu është Falë Profeti (a.s)".

Na doli një shkodran (El-Albani) përpara gati 40 vitesh me një libër për falje, i cili nuk përshtatet me asnjë medhheb me këtë titull: "Mënyra e faljes së Profetit (a.s) prej fillimit deri në fund, si ta shohësh me sy".

Më vonë, kur erdhën libra të ndryshëm tek ne, doli se ai kishte mbledhur temën e librit të vet nga shkrimet e disa indianëve, që merreshin me Hadith, mirëpo titullin e ka vënë vetë ai. Unë që merrem me mësime e dije fetare tash 60 vjet, theksoj se:

a. Ky libër gjatë ribotimeve ka ndryshime nga vetë autori, gjë që tregon se ai pa dashtë, deklaron se nuk ka gjetur ekuilibër në dijen e vet.

b. Ky dijetar (El-Albani) ka guxuar të thotë se Buhariu ka dy hadithe të dobëta e se Muslimi ka më shumë se 30 hadithe të dobëta. Ky është guxim i pa pëlqyer, pa fjalë.

c. Më tepër ky kundërshton veten me fjalë për disa hadithe.

2. Thotë për një Hadith, në një libër të vet: Është *hadith i dobët*, kurse, po për atë hadith, në një libër tjetër të vetin thotë se është *hadith i saktë*. Unë këtu po e lidhi lexuesin e këtyre fjalëve me një libër që është shtypur para katër vitesh (e po ribotohet) dhe u plotësua deri më sot në tre volume. Autori është H.Hasan Sakkafi.

Në këtë libër ti lexon se El-Albani në faqe të caktuara të librave të tij ka thënë për një Hadith se është i saktë, ndërkohë që ka kundërshtuar veten në faqet e tjera për të njëjtin hadith. Nga ky lloj dijetari është gabim me marrë dije, mbasi ai vetë kundërshton veten, d.m.th. tek ai vetë nuk ka gjet vend (cak) dija e tij. Thotë Sahabiu Abdullllah, djali i Mesudit: "Në qoftë se doni me pasu kënd prej dijetarëve, pasoni të vdekurit, mbasi të gjallëve nuk dihet se si u përfundon jeta".

Rini besimtare, merruni me libra të vjetra për të mësuar fenë, lexoni librat e punët e dijetarëve të njohur, mos u rreni me fjalë, me tituj, me shkrime, reklama e fjalë të disave që nuk janë dijetarë të njohur e që nuk e peshojnë fjalën e vet, bile edhe e harrojnë se kanë me u pyet për ç'ka besojnë e flasin te Zoti (xh.sh) në jetën e ardhshme.

BIDATI MË I RREZIKSHËM

Ne nuk flasim për Zotin (xh.sh), veç me çfarë na ka mësuar Vetë, ose Profeti i Tij (a.s), nuk i japim emra, as cilësime nga mendja e jonë. Zoti (xh.sh) ka thënë: "Nuk është kush si Ai dhe Ai është Dëgjuesi e Shikuesi" – (Kur'ani, Esh-Shura: 11).

Pra, është bidat me thënë p.sh se, Zoti (xh.sh) ka vend, se Ai i ka krijuar të gjitha vendet! Është bidat i madh me thënë është në qiell Vetë, ose përmbi qiejt Vetë, mbasi Ai i ka krijuar qiejt, atëherë ku ka qënë më përpara? Është bidat me i caktuar Zotit anë, sepse ajo anë, cilado që të jetë, është e krijuar nga Zoti (xh.sh). Ai thotë se nuk i ngjanë kujt.

Prandaj, kur të caktojmë vend, ose anë për Të, i bie të besojmë se Zoti është trup, ka zënë vend, mbasi nuk ka patur vend, ka marrë një anë, mbasi ka krijuar Gjithësinë, qiejt e tokën e me atë janë caktuar anët, lart apo poshtë, ajo është gabim, humbje e rëndë. "Është më afër se damari i fytit të çdo njeriu, është më afër të vdekurit se ata që janë te ai, mirëpo nuk shihni" – (Kur'ani, Kaf: 85). "Ne jemi me ju ku ju të jeni" - (Kur'ani, El-Hadid: 4). Të gjithë ato ajete i besojmë e themi se Zoti (xh.sh) nuk i ngjet kujt, ato ajete i lexojmë dhe ia mbështesim Zotit (xh.sh) për kuptimin e tyre, besojmë se ato janë si di e do Zoti (xh.sh), e si di e do Profeti (a.s) dhe se Ai nuk i ngjet askujt.

Le të ruhemi nga këto gabime e bidate që s'kanë ndërhy për ta, as të parët në kohë të Profetit (a.s), as sahabet, as të parët e katër medhhebeve, si përmendëm me fakte që nuk mohohen me fjalë të kundërta. Nuk pyetet për Zotin (xh.sh) si është, mbasi Atë, nuk e ka parë askush, e na ka thënë se nuk i ngjanë kujt (xh.sh). Nuk pyetet ku është, se Ai që ka krijuar vendin nuk bën me pasë marrë vend, mbasi krijoi Gjithësinë dhe se vendi mbushet me trup, kurse Zoti (xh.sh) nuk është trup. Nuk pyetet nga është (në cilën anë) se Ai, mbasi krijoi Gjithësinë, dolën anët e Krijuesi nuk bën me qenë si krijesat e Tij, me pasë nevojë për anë, lart e poshtë.

Thotë një Hadith: "Përmendni e mendoni në të mirat e Zotit (xh.sh) e mos mendoni në Zotin se sharroni". (Transmetuar nga Esbehani, etj)

HIXHRETI DHE DITA NDËRKOMBËTARE E TË MOSHUARVE

Hfz. Mehas Alia
Imam, "El-Hidaje", St.Gallen - Zvicër

Falënderimi i takon Zotit të gjithë botëve, salavatet dhe selamet i takojnë të Dërguarit të Tij, familjes, shokëve dhe gjithë atyre që e pasojnë për të mirë deri në ditën e gjykimit

"Besimtarë të vërtetë janë ata që besojnë fuqishëm në Allahun (xh.sh) dhe në Pejgamberin e tij, dhe pastaj nuk dyshojnë, si dhe me pasurinë dhe jetën e tyre luftojnë në rrugën e Allahut (xh.sh) Këta janë besimtarë të sinqertë." (Huxhurat, 15).

Të dashur vëllezër, të nderuara motra, sot është e xhuma dhe ditë e madhe për muslimanët. E xhumaja është dita festive e javës, por kjo festë nuk është festë që të deh, që të përgjum, që të largon nga përgjegjësia. Xhumaja është festa e vetëdijesimit tonë, është festa e afrimit me Allahun dhe kënaqjen me Të. Në ditën e xhuma muslimanët marrin energjinë e javës dhe në këtë ditë, muslimanët e ripërtërinë besën dhënë Allahut (xh.sh) dhe shoqërisë.

Të dashur xhemat, me pak rreshta dua të përcjell një mesazh në lidhje me kuptimin bashkëkohorë të Hixhretit. Në fakt, siç potencova më herët, Hixhret i thonë vitit kalendarik islamik, që në këtë të shtunë, me 01 tetor, me hyrjen e akshamit, shënojmë vitin e ri 1438 H. Por, nesër do të kemi edhe një ditë tjetër të veçantë, e ajo është dita ndërkombëtare e të moshuarve. Me këtë rast, dua të bëjë një lidhje midis Hixhretit dhe detyrave tona ndaj kësaj kategorie shoqërore.

Vëllezër dhe motra, I Dashuri ynë, Muhammedi (a.s), diti t'i vlerësojë dhe t'i çmojë shumë lartë gjyshet dhe gjyshërit, nënat dhe baballarët, duke u dhënë të drejtën e respektit dhe nderimit. Ai shumë shpesh thoshte: "Nuk është prej nesh ai i cili nuk i respekton pleqtë." Një ditë, teksa përgatiteshin muslimanët të bënin hixhret, i erdhi një djalë i ri Pejgamberit (a.s), dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, dua të bëjë edhe unë hixhret, ndonëse prindërit i kam lënë duke qarë për mua. Në çka Muhammedi (a.s) ia ktheu: "Kthehu tek prindërit e tu dhe qeshu atyre, ashtu siç i bëre të qajnë".

Këto fjalë të Pejgamberit (a.s) më duket sikur sot janë thënë, e ndjejë gjallërinë e tyre. Sikur sot njerëzit t'i kuptonin drejtë këto fjalë, vallë, sa prindërve të moshuar do t'u thahej loti, e do t'u kthehej buzëqeshja. Sa të moshuarve sot u mohohet e drejta e banimit me fëmijët e tyre? Sa të lënduar janë sot ata nga sjelljet e pahijshme të të rinjve? Sa të moshuar sot vdesin rrugëve, në kërkim të fatit më të mirë për jetesë, edhe pse në moshë të thyer?! Sa të moshuar sot vdesin në rrënojat e shtëpive të bombarduara nga njerëz të djallëzuar? A nuk është koha që sot të bëjmë një hixhret, një lëvizje drejt përmirësimit tonë të raporteve midis njëri-tjetrit. Një hixhret që na bënë më shumë respektues ndaj pleqve, ndaj nënave dhe baballarëve, etj.

Kurse hixhreti i pleqve, për veten e tyre, do të ishte që të afrohen me tepër me Allahun, mbase edhe vitet i kanë afruar më shumë me takimin me Të, andaj, hixhreti i tyre është ta mbajnë, sa më shumë që është e mundur, rrugën e xhamisë dhe të njëjtën t'ua mësojnë edhe nipërve dhe mbesave të tyre.

Nëse e shikojmë periudhën e para hixhretit të Muhammedit (a.s) dhe pas, do të shohim se ka, në masë të madhe, dallime në prioritetet e Islamit. Me pak fjalë mund të thuhet se Islami në Meke ishte më tepër teorik, besimor, kurse në Medine, kemi Islamin praktik, atë të dimensionit tokësor, të sistemuar me rregulla dhe ligje.

Vetë fakti që Muhammedi (a.s) vendosi që të jetojë deri në fund të jetës në Medine, dëshmon për ne faktin, mendoj unë, se, nëse ne dëshirojmë të shpëtojmë, duhet të jetojmë me Islamin praktik, atë të Medines. Pa një Islam, që i ngjan atij medinas, e kemi shumë të vështirë t'i shkojmë pas ajetit kuranor i zbritur në Meke, por në etapën medinase: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë time dhe zgjodha për ju Islamin fe." (El-Maide, 3)

Sot hixhreti ka po këtë kuptim: Ta jetojmë Islamin plotësisht, ose atë që pejgamberi i Zotit, Ibrahimi (a.s) tha: "Unë jam muhaxhir drejt Zotit tim". (Ankebut, 26)

(Hytbeja e xhumasë,
e mbajtur, më 30.09.2016,
në xhaminë El-Hidaje, St. Gallen - Zvicër)

HISTORIA E BESIMIT MYSLIMAN NË FSHATIN FLET

Gëzim Kopani
Myfti i Pukës

Fshati Flet ndodhet rreth një orë larg me makinë nga qendra e qytetit të Pukës. Edhe pse jo shumë i madh është ndër fshatrat më të njohur dhe më të përmendur në rrethin e Pukës dhe më gjerë.

Sipas të dhënave rreth vitit 1888, ky fshat thuhet të ketë pas rreth 35 shtëpi myslimane nga të cilat 4 të besimit katolik.[1]

Nga disa të dhëna të grumbulluara rreth viteve 1920-1929 del se fshati Flet të ketë pasur rreth 34 shtëpi, nga të cilat 9 të besimit katolik.[2]

Si myslimanët ashtu edhe katolikët janë fis me Iballen, ku myslimanët quhen Buçagjegjaj ndërsa katoliket Përgjegjaj.[3]

Nga ana administrative fetaro-islame fshatrat si; Trun, Flet, Lejthizë, Sakat (Blerim), Xathë dhe Kulumri mbuloheshin nga hoxhallarët e Myftinisë së rrethit të Pukës.[4]

Fshati Kulumri në vitin 1888 mësohet të këtë pas rreth 35 shtëpi myslimane. Nga të dhënat popullore fjala Kulumri vjen prej fjalës Kulm, kulmi i lodhjes , mri[5] në pikun e lodhjes . Ndërsa nga ana shkencore del se fjala Kulumri vjen nga fjala kulm, nga ku del edhe fjala Kal që do të thotë Udhë.[6]

Fakti që Udh Madhja lidhte Shqipërinë me Kosovën bëri që fshati Kulumri të bëhet një pikë pushimi dhe referimi për udhëtarët. Sipas të dhënave popullore kemi se fshati Kulumri ishte pikë e rëndësishme pushimi madje ata vendosën edhe një mesxhid[7] ku të kryenin ritet fetare. Pas disa vitesh, ushtarët Osmanë të mbështetur edhe nga banorët e fshatit Kulumri vendosën të ndërtonin xhamin e fshatit Kulumri. Xhamia u ndërtua në Kulumri për faktin se ndodhesh në mes të rrugës Udhe Madhe si dhe të fshatrave myslimane. Xhamia e fshatit Kulumri kishte një kapacitet prej 100 personash. Xhamia ka qenë dy katesh. Ka pas Hajatin e Myezinit si dhe një hytbe të gdhendur me dru arre. Xhamia shërbente për fshatrat: Kulumri, Lejthizë, Sakat, Xathë e Flet.[8]

Sipas të dhënave në fshatin Flet paskan qenë tre vëllezër; 1. Përgjegji, 2. Gegë Gjegji dhe Buç Gjegji. Ky i fundit u ba mysliman.

Sipas të dhënave të grumbulluara në vitin 1929 del se Buçgjegjaj janë bërë 30 shtëpi. Sipas këtij shënimi fshati Flet ishte i ndarë në 3 lagje myslimane e një lagje katolike.[9]

Edhe sot në fshati Flet ndodhen 3 lagje myslimane, të cilat quhen: 1. Sylaj 2. Xhauri dhe Velaj dhe një lagje katolike që quhet Kolaj.[10]

Të dhënat sipas lagjeve në fshatin Flet është si më poshtë:

Në lagjen Sylaj ndodhen rreth 7 familje, të cilat jetojnë aktualisht.

Në lagjen Xhauri ndodhen rreth 7 familje, të cilat jetojnë aktualisht në fshatin Flet.

Ndërsa në lagjen Velaj ndodhen rreth 9 familje, të cilat jetojnë aktualisht në fshatin Flet.

Ndërsa në lagjen katolike "Kolaj" aktualisht jetojnë rreth 4 familje.[11]

Fshati Flet si edhe fshatrat e tjerë si Xathi, Truni, Sakati, Fleti e Kulumria ishin të lidhur ngushtë me njeri-tjetrin.

Sipas Ali Zmakës (ish-banor i fshatit Flet) kemi se: "Ne xhamin e fshatit Kulumri kanë shërbyer si hoxhë Osman Hoxha, Azman Hoxha, Zenel Hoxha dhe Mehmet Hoxha. Hoxhë Mehmeti e ka pas shtëpinë midis fshatit të Fletit. Ndërsa Baram Haziri dhe Isen Hoxha ka qenë Myezin. Mbaj mend se për bajrame u mbushte xhamia dy katëshe. Ma do mendja rreth 150 burra falshin bajramin. Nga kallaballëku i madh kanë qenë falë edhe jashtë. Për faljen e bajramit vinin nga Kulumria, Lejthiza, Xathi, Fleti, Sakati. Ka pasur raste që vinin edhe prej fshatit Pistë.

Fshati Kulumri, Flet, Xathe e kanë pasur për zakon me marr hoxhën për me këndu mevlud nëpër shtëpia. I veçantë ishte muaji Ramazan, ku organizoheshin faljet e namazit të teravive në disa shtëpi të Fletit si dhe në xhami. Fletasit thirrnin hoxhën dhe ai fillonte sipas kërkesës duke ju shërbyer me namazin e teravive si edhe duke ju lexuar salavate dhe Kur'an. Kur vinte festa e bajramit bashkoheshim të gjithë burrat e fshatit dhe udhëtonim në këmbë për me falë namazin e Bajramit në xhaminë e Kulumrisë."[12]

Vitet e fundit Myftinia e rrethit Pukë, ka treguar kujdes të veçantë në grumbullimin e fakteve historike të besimit islam në rrethin e Pukës.

1. Shënime nga imam Gezim Kopani, "Historia e besimit mysliman në fshatin Flet" viti 2006.
2. Karma,Gjon, "Ndër Malet Tona" fq.28
3. Karma, Gjon, "Ndër Malet Tona" fq.28
4. Arkivi i Myftinisë së rrethit Pukë
5. Mri; arrin.
6. Mesxhid, vend ku myslimanët gjatë udhëtimeve kryejnë rite fetare.
7. Shënime nga imam Gëzim Kopani, "Historia e xhamisë Kulumri" viti 2006.
8. Shënime nga imam Gëzim Kopani, "Historia e xhamisë Kulumri" viti 2006.
9. Karma, Gjon, "Ndër Malet Tona" fq.28.
10. Arkivi i Myftinisë së rrethit Pukë.
11. Shënime nga imam Gëzim Kopani "Historia e besimit islam në Flet" viti 2014.
12. Shënime nga imam Gëzim Kopani "Histori i xhamisë Kulumri" viti 2011.

LOZANË, MYFTIU I SHKODRËS LIGJËRON MBI VLERAT E HIXHRETIT

Me ftesë të Qendrës Islame Shqiptare të Lozanës dhe Kryetarit të saj, Fehim Abazi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë treditore në Lozanë të Zvicrës.

Në program të vizitës ishte edhe dersi dhe hytbeja e xhumasë, më 7 tetor 2016, si dhe ligjërata mbi vlerat dhe dimensionet e Hixhretit profetik, në tribunën fetare, më 8 tetor 2016.

Gjatë takimeve me besimtarë, bashkëbisedimeve të shumta, pyetje-përgjigjeve, dersit të xhumasë, hytbes së saj dhe ligjëratës mbi vlerat e Hixhretit, Myftiu theksoi se mbi të gjitha, muslimanët e sotëm duhet të zgjohen nga pasiviteti dhe mosorganizimi shoqëror, por duhet të shohin përpara për të ndërtuar lavdinë bazuar mbi thelbin e fesë së tyre dhe mesazhet qytetëruese, që ajo rrezaton.

"Realitetet e sotme, po luajnë rolin e tyre për frikësimin e njerëzve nga Islami, ku përçudnimi i imazhit të tij, nëpërmjet dhunës, vrasjeve barbare, djegies e terrorit, (me të cilët feja e jonë nuk ka asnjë lidhje, as mund të ketë) po kthehen në një shqetësim global dhe një ftesë për reflektim, sidomos për elitat.

Le të ndalemi pak dhe të lexojmë së bashku: 1. "Musliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit janë të shpëtuar krejt muslimanët, ndërsa muhaxhir, është ai që largohet nga ndalesat e All-llahut" – (Bukhariu dhe Muslimi) 2. "Me të gjitha cilësitë vuloset personaliteti i besimtarit, përveç tradhëtisë dhe gënjeshtrës" – (Ahmedi) 3. "Ruajuni nga paragjykimi, sepse paragjykimi është biseda më gënjeshtare! Mos e spiunoni dhe mos e nxitni për keq njëri-tjetrin! Mos u urreni! Jetoni si vëllezër..." – (Bukhariu dhe Muslimi 4. "... Muslimani është haram për muslimanin; gjaku i tij, pasuria e tij, nderi i tij!" – (Bukhariu) Etj, pa fund.

Kësisoj, le ta dëshmojmë me krenari e dinjitet përkatësinë tonë fetare, nëpërmjet shembullit të jetuar, modelit praktik, duke u bërë thirrës të gjithësisë drejt Islamit të pastër, fesë së All-llahut dhe misionit hyjnor të krejt të dërguarve të Tij!" - ligjëroi ndër të tjera Myftiu.

LOZANË, SHFAQET DOKUMENTARI I 25 VJETORIT TË LIRISË SË BESIMIT

Mbrëmjen e së shtunës, më 8 tetor 2016, në kuadër të tribunës fetare në përkujtim të Hixhretit 1438, organizuar nga Qendra Islame Shqiptare në Lozanë të Zvicrës, u shfaq pë herë të parë edhe dokumentari me titull: "Triumfi i zanit të minareve...", prodhim i Myftinisë Shkodër, me rastin e 25 vjetorit të lirisë së besimit.

Në prag të shfaqjes së dokumentarit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tha për të pranishmit e shumtë se, dokumentari në fjalë është një përpjekje për të nxjerrë në pah dhimbjen dhe absurditetin e diktaturës ateiste dhe luftën e saj të hapur kundër Islamit dhe muslimanëve në Shqipëri, sikurse dëshmon edhe faktin se thirrjet e shpirtit dhe "zanin e minareve", nuk ka forcë, pushtet e diktaturë në botë që ta mposhtë.

Shfaqja e dokumentarit u shoqëria me emocione dhe thirrje tekbiresh nga të pranishmit. Të shumtë ishin që u përlotën, sidomos gjatë shfaqjes ekskluzive të pamjeve të rralla të

datës historike 16 nëntor 1990, kur te Xhamia e Plumbit u zhvillua ceremonia madhështore e faljes së xhumasë në liri, pas 23 viteve persekutim, dhunë dhe terrorizëm shtetëror kundër muslimanëve dhe jetës fetare në Shqipëri.

Në përfundim të kësaj shfaqjeje me vlera, Kryetari dhe imami i Qendrës Islame Shqiptare në Lozanë, Fehim ef. Abazi, pasi falënderoi Myftiun e Shkodrës për praninë e tij dhe dokumentarin e përgatitur, theksoi se emocionet e përjetuara në këtë mbrëmje duhet të shërbejnë si një nxitje më shumë për të parë secili në pasqyrën e zemrës, për të rritur besimin dhe për të shtuar kapjen pas fesë tonë të shtrenjtë islame.

"RRËNJËT ISLAMIKE TË EVROPËS", LIBËR ME VLERA

Ditën e mërkurë, më 12 tetor 2016, Myftinia Shkodër zhvilloi një bashkëbisedim rreth librit: ***"Rrënjët islamike të Evropës"*** me autor Massimo Jevolella, përkthyer nga Zija Vukaj.

Aktivitetin e hapi teologu Arben Halluni, i cili në emër të Myftinisë Shkodër i uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe falënderoi përkthyesin Zija Vukaj për punën e tij të vlefshme në përkthimin e këtij libri. Ai theksoi se libra të tillë janë ftesë për të gjithë njerëzit, që të njohin realitetin rreth Islamit dhe myslimanëve në Evropë.

Përkthyesi i librit, z. Zija Vukaj bëri një përmbledhje të librit duke theksuar se dëshira për përkthimin e librit i lindi menjëherë pas leximit të tij, duke parë se libri në fjalë është një argument dhe fakt, se Evropa ka në rrënjët e saj qytetërimin islam. Ai ndër të tjera bëri një jetëshkrim për autorin e librit, Massimo Jevolella, i cili ka një aktivitet të dendur në fushën e eseistikës ("Akme", "Studime katolike", "Servitium", "Panorama", "Millelibri" etij), korrespondent i kulturor në "Il Giornale" dhe drejtor në "Meridian".

Gjithashtu përkthyesi Vukaj ftoj të pranishmit dhe këdo, që ka dëshirë të mësojë rreth të vërtetës së rrënjëve të Evropës, të lexojnë librin "Rrënjët Islamike të Evropës", sepse libri është i gjithi fakte dhe të vërteta, të cilat shumë prej njerëzve nuk i njohin dhe nuk i kanë njohur.

Më pas fjalën e mori teologu Lavdrim Hamja, i cili falënderoi të pranishmit për përgjigjen e ftesën dhe në emër të Myftiut të Shkodrës, u përcolli selamet dhe përshëndetjet e rastit. Teologu Hamja theksoi se një libër i tillë erdhi në kohën e duhur, duke ditur se përhapja e islamofobisë dhe deformimi i imazhit të Islamit dhe myslimanëve, janë gjëra të pabaza dhe aspak të vërteta.

Islami është përhapur gjithmonë me paqe dhe bindje, e asnjëherë me dhunë. Evropa e mori qytetërimin nga Islami dhe myslimanët dhe për këtë duhet të jetë mirënjohëse. Myftinia Shkodër ka qenë dhe do të jetë promotor i përçimit të vlerave, dijes dhe kulturës së bukur islame dhe myslimane. Ai falënderoi z. Zija Vukaj për përkthimin e tij të dobishëm për mbarë lexuesit shqipfolës.

Këtë aktivitet e përshëndetën edhe drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, i cili përmendi kontributin dhe punën e palodhur të profesor Zijasë, që po jep në fushën e letërsisë, me shkrimet, redaktimet dhe përkthimet e tij me vlerë.

Shkrimtari Xhahid Bushati, falënderoi përkthyesin e librit, z. Vukaj dhe Myftininë Shkodër për këtë aktivitet, që vjen në kuadër të muajit të librit, muajit tetor.

Gjithashtu përshëndeti edhe Prof. Dr. Bajram Xhafa, i cili vlerësoi shumë librin dhe shtoi se, luftërat e bëra në Ballkan kanë qenë viktimizim i Islamit dhe i myslimanëve, duke përmendur faktin e shpërnguljes së një milion myslimanëve në fund të shek. XIX dhe gjithashtu lufta I Botërore dhe luftërat ballkanike.

Në aktivitet morën pjesë imamë, intelektualë, drejtues të Medresesë, të dy degëve të saj, djem dhe vajza, mësues dhe besimtarë.



"Pas mijëra vitesh urrejtjeje të egër dhe gënjeshtrash të tmerrshme, thuajse papritur në epokën e Iluminizmit, Evropa zbuloi "magjinë islame" e, për herë të parë, me Gëten e Carlyle kultura perëndimore njohu edhe madhështinë e figurës së Muhamedit, Profetit të Allahut. Nga ky moment, falë përparimit të studimeve orientaliste, filloi të pranohej nga mjaft intelektualë perëndimorë se qytetërimi lindor ka luajtur një rol themelor në rilindjen e Evropës pas vitit Një mijë."

RRËNJËT ISLAMIKE TË EVROPËS

Rreth vitit Një mijë, ndërsa Perëndimi i krishterë ishte zhytur në fazën e një prapambetjeje të thellë që zgjati pesë shekuj, një valë e fuqishme qytetërimi, shkence e kulture e ardhur nga bota islamike filloi të zbrazej mbi Evropë, duke e shkulur atë nga pazhvillimi dhe duke e hedhur drejt pushtimit të Humanizmit dhe Revolucionit shkencor të shekujve XIV- XVII. Prandaj është me vend të theksohet që Islami bën pjesë me plot të drejtë në rrënjët tona.

I frymëzuar edhe nga përvojat e sapojetuara përgjatë disa udhëtimeve mes shkëlqimeve islamike të Andaluzisë e të Siçilisë, Massimo Jevolella tregon fazat e spikatura të këtij "vërshimi të paçmueshëm të qytetërimit" përmes një sëre episodesh tërheqëse e pjesërisht të padëgjuara, me stilin e romanit dhe saktësinë e rindërtimit më të rreptë historik, për t'u mbyllur me një kapitull kushtuar shkrimtarëve dhe artistëve evropianë që mes shekujve XVIII e XIX udhëtuan në zbulim të botës së larme të Gjysmëhënës.

I lindur në Milano në vitin 1950, islamist dhe studiues i feve abrahamike, Massimo Jevolella është gazetar nga viti 1975: korrespondent i posaçëm në "Epoka" dhe pastaj korrespondent kulturor në "il Giornale", dhe drejtor në "Meridiani". Ka bashkëpunuar me Institutin e Historisë së filozofisë të Universitetit të Studimeve të Milanos. Ka një aktivitet të dendur në fushën e eseistikes ("Akme", "Studime katolike", "Servitium", "Panorama", "Millelibri", "Il sole 24 Ore"). Ka përgatitur një botim të veprës "Një mijë e një net" (1984) dhe "Një mijë e një ditë" të Peti de la Krua (1985) dhe ka përkthyer klasikë të letërsisë arabe. Ndër librat e tij mund të përmendim, "Historia e 'Abd el-Masih dhe e prapësive të tij" (1981), "Ëndrrat e historisë" (1991) dhe "Mos e ve mend kot emrin e Allahut" (2004).

TAKIM ME HAXHILERËT SHKODRANË TË KËTIJ VITI

Paraditën e së shtunës, më 15 tetor 2016, Myftinia Shkodër organizoi një takim vëllazëror me haxhilerët shkodranë të këtij viti.

Me këtë rast, u këmbyen urime dhe lutje për pranim e Haxhit dhe mbarësinë e haxhilerëve në jetë.

I pranishëm në këtë takim të përzemërt ishte edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, Drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, imamë e familjarë haxhilerëve.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, theksoi se haxhilerët janë si një familje besimi dhe vlerash, që shpërndajnë kudo mirësitë e adhurimit dhe besimit në All-llah. Ai tha se tashmë, secili prej tyre duhet ta konsiderojë veten e tij si një thirrës islam, që shpërndan kudo rrezatimet e paqta të Haxhit, shpirtin e madhështisë së besimit, moralin, paqën e bukurinë e Islamit.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, i cili pasi uroi haxhilerët, theksoi se emocionet e takimit me "të ftuarit e All-llahut" janë të mëdha, sidomos kur kujtojmë madhështinë e këtij adhurimi, vendet e shenjta që vizitohen, emocionet që përftohen, përshpirtjet që fitohen etj.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe teologu Ruzhdi Plangaj, i cili këtë vit ishte murshid i grupit. Ai falënderoi krejt të pranishmit dhe haxhilerët e tjerë që munguan për frymën e bashkëpunimit dhe mirësitë e përjetuara në ditët e Haxhit.

Më pas, shumë prej haxhilerëve të këtij viti ndanë së bashku emocione dhe kujtime të pashlyera nga udhëtimi i bukur dhe i paharruar i këtij viti, ai i vendeve tona të shenjta në Mekë dhe Medine.

"LARG DROGËS, ALKOOLIT, LOJRAVE TË FATIT...", BASHKËBISEDIM ME MATURANTË

Paraditën e së enjtes, më 20 tetor 2016, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta në mes Myftinisë Shkodër dhe Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një bashkëbisedim me një grup maturantësh, rreth fenomeneve të dëmshme, si: droga, alkooli, duhani, lojrat e fatit etj.

Aktiviteti, që u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë në djepin e dijes dhe edukimit islam, u përqendrua tek mesazhi i Myftiut, i cili ndër të tjera tha: "Të gjithë ne, po ndjekim prej vitesh me shqetësim të madh përhapjen në masë të alkoolit, duhanit, basteve, të quajturave "lojra të fatit", kumarit, shthurrjes morale, divorceve për shkak të dhunës në familje, tradhëtive bashkëshortore, degradimit të moralit dhe zhdukjes së turpit nëpërmjet keqpërdorimit të rrjeteve sociale, si fb, instagrami etj., si dhe së fundi, përhapja në masë e mbjelljes,kultivimit dhe përhapjes së bimëve narkotike dhe drogërave të ndryshme, që po kthehen në një gangrenë të dhunshme për shoqërinë shqiptare, rininë në veçanti!

Nga pozita e Myftiut të Zonës Shkodër dhe në emër të Myftinisë Shkodër, ftoj të gjithë besimtarët muslimanë dhe bashkëqytetarët e mi, rininë e shtrenjtë në veçanti, të distancohen nga krejt sa përmenda më lart, sepse konsumimi i duhanit, alkoolit (me krejt llojet e tij), drogërave, është shkaktar i dëmeve të pallogaritura morale, shëndetësore, ekonomike, sociale, por jo vetëm!

Njëkohësisht, tërheq vëmendjen e krejt besimtarëve dhe bashkëqytetarëve të mi për të mos e humbur kohën, shëndetin dhe pasurinë e hallallit pas bixhozit, basteve, kazinove, sepse nuk është në natyrën e muslimanit dhe besimtarit frekuentimi i vendeve ku shkelet fjala e Zotit, ku dëmtohet familja, ku prishet morali, ku njeriu kthehet në skllav i shejtanit të mallkuar, epsheve dhe kapriçove, tekave dhe errësirës!"

Myftiu theksoi gjithashtu, se: "Në mënyrë kategorike, ne si bashkësi fetare, si besimtarë muslimanë, distancohemi nga këto fenomene, sikurse bëjmë thirrje publike për të gjithë bashkëqytetarët tanë dhe institucionet tona, që ta ruajmë vendin, shoqërinë, individin dhe familjen shqiptare nga katastrofa e drogës, pijeve dehëse, bixhozit, basteve, kazinove dhe hashashit! Njëkohësisht ftojmë bizneset mbarë, ato të muslimanëve në veçanti, të distancohen nga shitblerja dhe përdorimi i pijeve alkoolike, duhanit dhe drogërave, që sjellin vetëm dëme të shumëanëshme, harame e mallkime hyjnore!"

Nijë mesazh plot urtësi dha edhe drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, i cili vlerësoi këto takime si një sensibilizim me dobi, në një kohë, kur gjithandej po përhapen alarmet e rrëshqitjes së rinisë drejt këtyre fenomeneve të rrezikshme.

Ai theksoi se është mirësi e madhe e Zotit, që medresistët edukohen me një moral të lartë dhe me një disiplinë të admirueshme fetare dhe shkencore, larg veseve dhe rrezikut të tyre.

Bashkëbisedimi vijoi me ndërhyrjet e vyera të maturantëve, shembuj konkretë nga përditshmëria e marrëdhënieve të tyre me bashkëmoshatarë etj.

Ky bashkëbisedim me vlerë u pasurua edhe me ndërhyrjet e teologëve Arben Halluni dhe Evans Drishti.

MYFTIU, KËSHILLA PRINDËRORE ME KONVIKTORËT E MEDRESESË

Me ftesë të drejtorit të konviktit të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Gezim Dungaj, mbrëmjen e së martës, më 18 tetor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një bisedë fetare, me këshilla prindërore drejtuar medresistëve që banojnë në këtë vatër edukimi.

Pas faljes së namazit të akshamit me xhemat, Myftiu mbajti një këshillë fetare, në thelbin e së cilës ishte këshilla e Hz. Lukmanit (a.s), me të cilën iu drejtua të birit.

"Këshillën e artë, me të cilën i urti Lukman iu drejtua të birit, e përjetësoi All-llahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë, kur tha: "Përkujto, kur Lukmani i tha të birit: Biri im, mos i bëj shirk All-llahut, sepse shirku është një padrejtësi shumë e madhe"! Madje, e emërtoi keejt suren me emrin e të urtit Lukman!

Ky përjetësim, sikur na thotë se, në jetën tonë, përherë kemi nevojë për një këshillë të urtë, për një mbështetje, për një fjalë me vlerë. Dhe, më e vlefshmja këshillë dhe urti është ajo e ruajtjes së ekuilibrit në jetë, mosrrëshqitja në shirk, sepse shirku është vërtetë një devijim logjik dhe një padrejtësi shumë e madhe që njeriu i bën vetes. Shirku është degradimi më i rëndë i racës njerezore!

Si mundet njeriu, që e njeh All-llahun, Zotin e vetëm të galaktikave, të gjithësisë, Atë që është i përhershëm pa fillim, i përhershëm pa mbarim, që ka në dorë e Tij çdo gjë; jetën, vdekjen, rizkun, përgjigjen e lutjes, çdo gjë pa përjashtim! Si mundet njeriu t'i lutet gurit e drurit, njeriut e lopës?! Paradoks i madh!" - tha ndër të tjera Myftiu.

Ai kërkoi nga të pranishmit, që të luten për çdo gjë, mos të stepen e mos të kenë ndrojtje për të kërkuar nga Zoti i gjithësisë, me kokë në sexhde, sidomos para kohës së sabahut, "sepse lutja është shenjë e fortë e besimit dhe e dorëzimit para dashnisë së Zotit!" -, tha Myftiu.

KULLAJ, MYFTIU NXIT PËRHAPJEN E THIRRJES ISLAME

Mbrëmjen e së enjtes, më 20 tetor 2016, në kuadër të iniciativës së ndërmarrë nga Myftinia Shkodër për zhvillimin e derseve pas namazit të akshamit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari u ndal në xhaminë e re të fshatit Kullaj, Postribë.

Pas faljes së namazit të akshamit me xhematë, Myftiu nisi dersin e tij, ku u përqendrua te mesazhet e përhapjes së Thirrjes Islame në jetën e përditshme.

"Ka shumë rëndësi në jetën tonë, të jemi të gatshëm ta vendosim All-llahun para krejt gjërave të botës, para krejt interesave, edhe para dëshirave tona, edhe para jetës, edhe para familjes, fëmijëve, pasurisë! Ky është Islami! Të thonë sot, se duhet bërë kështu e ashtu, për shkak të integrimit evropian. E duam integrimin evropian, por duam fenë tonë dhe shenjtëritë tonë mbi krejt Evropën e mbarë botën! Sepse Islami, me vlerat e tij qëndron edhe në themelet e Evropës!

Ju etiketojnë sot, me lloj-lloj shpifjesh e gënjeshtrash, që vetë i kanë shpikur. Ju mos u trazoni fare! A jeni ju ashtu si ata thonë? A jemi ne muslimanët ashtu si thonë disa edhe në trojet shqiptare, për ne? Nuk jemi! Atëherë? Atëherë, të punojmë me sa të kemi mundësi e forcë, me krejt energjitë tona për përhapjen e kësaj feje të pastër e të madhnueshme në jetë! Secili të bëhet thirrës islam në familje, në rrugë, në punë, me këdo e kudo!

Pyete veten: Sa njerëz janë udhëzuar në Islam falë angazhimit tënd? Sa personave ju ke folur me zemër të hapur e me buzëqeshje të sinqertë? Sa muslimanë me emra janë udhëzuar në duart tuaja?

Prandaj, ju ftoj që të ngrihemi e të punojmë pa ndrojtje, pa paragjykime! Ndarja nga njerëzit është e lehtë, por ne duam të afrohemi e të bashkohemi me ta, t'u përcjellim Fjalën e Zotit, Islamin!" - ka porositur Myftiu.

NË RAHMET TË ALL-LLAHUT, SHEJKH SHUAJB MUHARREM ARNAUTI

Mbrëmjen e së enjtes, më 27 tetor 2016, në kryeqytetin e Jordanisë, Amman, ndërroi jetë në moshën 88 vjeçare dijetari i shquar islam me prejardhje shqiptare, nga qyteti i Shkodrës, Hirësia e Tij, Shejkh Shuajb Arnauti.

Enciklopedisti i shquar islam, Shuajb Arnauti, lindi në vitin 1928 në Damask të Sirisë, një vit pasi i ati, Muharremi, emigroi drejt Damaskut, bashkë me familjen e tij.

Mësimet e para i mori nga familja, e më pas para duarve të Hafiz Sulejman Gavoçit.

Hoxha Shuajb Arnauti njihet si verifikuesi më i madh dhe më i shquar i trashëgimisë islame në botën islame.


SHEJKH SHUAJB ARNAUTI

Veprat e punuara prej tij arrijnë në qindra vëllime, sidomos në shklencat e Hadithit dhe trashëgimisë islame shekullore, fakt që e bën atë, njërin ndër personalitetet më të shquara të shekullit.

Për herë të fundit, ai e vizitoi Shkodrën në korrik të viti 2011, ku iu akordua edhe titulli "Qytetar Nderi" i Shkodrës.

Ndër porositë e tij drejtuar popullit shqiptar, është edhe mesazhi publik, ku ai i drejtohet shqiptarëve me këto fjalë: "Pavarësisht kohërave të errëta që kaloi vendi, duhet që sot, të zgjoheni dhe të ruani amanetin e të parëve tuaj! Qëndroni, mos e leni kte fé! Rune besën e t'parve tuj!"

Me udhëzim të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ditën e sotme, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u fal namazi i xhenazes në mungesë, për shpirtin e tij.

IMAMËT: "TË SHTOHEN AKTIVITETET E LARMISHME PËR RININË MUSLIMANE!"

Pasditen e së enjtes, më 27 tetor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe të fshatit.

Në qendër të takimit ishte domosdoshmëria e rritjes dhe përmirësimit të aktivitetit thirrës, sidomos me rininë muslimane, në rrethanat e reja të shtimit të numrit të rinisë muslimane shkodrane, që po frekuenton xhamitë, në veçanti për namazin e xhumasë dhe vaktet kryesore të ditës.

U diskutua mbi nevojën e madhe të gjallërimit të sektorit të rinisë dhe atij të arsimit, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe përhapjen e jehonës së tyre në komunitet.

Njëkohësisht, u kërkua vazhdimi i ciklit të derseve të së enjtes, pas akshamit, si një lëvizje e goditur që po tërheq vëmendjen e besimtarëve, sidomos në xhamitë e fshatrave.

Në fjalën e tij, teologu Lavdrim Hamja, në rolin e sekretarit organizativ

të Myftinisë Shkodër, rreshtoi disa prej pikave kryesore, që duhet të kihen parasysh në funksion të disiplinimit të organizimeve fetare dhe thirrëse në xhamitë tona.

U diskutua edhe mbi nevojën e përzgjedhjes së matur të temave për hytbet e xhumasë, si dhe bashkëbisedimet me xhematin, me qëllim përhapjen e mesazheve të urta dhe shëruese.

Nga imamët u kërkua koordinimi për zhvillimin e aktiviteteve të larmishme, sidomos me të rinjtë dhe të rejat, që frekuentojnë në rritje xhaminë.

Mendime të vyera dhanë edhe imamët e xhamive: Guri i Zi, Dragoç, Luarëz, Rus, Shtoj i Ri, Milan etj.

"TË GJITHË NE, PO NDJEKIM PREJ VITESH ME SHQETËSIM TË MADH PËRHAPJEN NË MASË TË ALKOOLIT, DUHANIT, BASTEVE, TË QUAJTURAVE "LOJRA TË FATIT", KUMARIT, SHTHURRJES MORALE, DIVORCEVE PËR SHKAK TË DHUNËS NË FAMILJE, TRADHËTIVE BASHKËSHORTORE, DEGRADIMIT TË MORALIT DHE ZHDUKJES SË TURPIT NËPËRMJET KEQPËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE, SI FB, INSTAGRAMI ETJ., SI DHE SË FUNDI, PËRHAPJA NË MASË E MBJELLJES, KULTIVIMIT DHE PËRHAPJES SË BIMËVE NARKOTIKE DHE DROGËRAVE TË NDRYSHME, QË PO KTHEHEN NË NJË GANGRENË TË DHUNSHME PËR SHOQËERINË SHQIPTARE, RININË NË VEÇANTI!

NË MËNYRË KATEGORIKE, NE SI BASHKËSI FETARE, SI BESIMTARË MUSLIMANË, DISTANCOHEMI NGA KËTO FENOMENE, SIKURSE BËJMË THIRRJE PUBLIKE PËR TË GJITHË BASHKËQYTETARËT TANË DHE INSTITUCIONET TONA, QË TA RUAJMË VENDIN, SHOQËRINË, INDIVIDIN DHE FAMILJEN SHQIPTARE NGA KATASTROFA E DROGËS, PIJEVE DEHËSE, BIXHOZIT, BASTEVE, KAZINOVE DHE HASHASHIT!"

(IMAM MUHAMED SYTARI, MYFTI I ZONËS SHKODËR)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek